



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.465/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Gentipharm” SH.P.K, me NUI: 810812124, me seli në Drenas, Gllogoc, përfaqësuar nga Rafet Ferizi avokat sipas autorizimit nga pronari D.Sh., kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.10/K-90-20- të datës 12.11.2020 me numër protokolli 05-6116/3, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 29.04.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 30.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Gentipharm” SH.P.K, me NUI: 810812124, me seli në Drenas, Gllogoc, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, me çka ka kërkuar të anulohet Vendimit Nr.10/K-90-20- të datës 12.11.2020 me numër protokolli 05-6116/3 i të paditurës, si e pabazuar.
  
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 23.12.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi “Gentipharm” SH.P.K, me NUI: 810812124, me seli në

Drenas, Gillogoc, përfaqësuar nga pronari D.Sh., ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, kë kërkesë për anulim të Vendimit Nr.10/K-90-20- të datës 12.11.2020 me numër protokollit 05-6116/3. Lënda është evidentuar me nr A.2231/2020.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 465/22.
3. Më datë 29.04.2024 Gjykata caktoi dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Rafet Ferizi avokat sipas autorizimit të dhënë verbalisht në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor nga pronari D.Sh., ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur – Avokatura Shtetërore, (konform nenit 41 të LKA-së) të ftuar në mënyrë të rregullt e cila është deklaruar për seancë me parashtrësë.

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Inspektoratit të Shëndetësisë me të cilin është dënuar me gjobë prej 1,000 euro, pa të drejtë për një furnizim në vlerë prej 16 euro tek biznesi siç është i paraqitur në shkresa të lëndës. Ministria e Shëndetësisë e ka refuzuar ankesë si të pas afatshme, duke llogaritur afatin vetëm në dite pune e jo edhe festa e vikende. Ka deklaruar se Ministria e Shëndetësisë përveç mbikëqyrjes e mekanizimit të shpërndarjes së barnave duhet të ketë një rol mbështetje për prodhuesit vendor. Mos marrja e arsytiveve për vonesën e paraqitjes së ankesës e dëshmon qartë që vendimi i parë për shqiptimin e gjobës ka qenë i kundërligjshëm dhe i pa bazuar në asnjë provë tjetër i propozoj gjykatës të anulohet vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë për shqiptimin e gjobës për Gentipahrm Shpk.

#### Kundërshtimet e të paditurës

5. Përfaqësuesi i të paditurës, në parashtrësë të 29.04.2024 ka deklaruar se e kundërshtojnë padinë e paditësit ai të pabazuar, me arsyetim se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për produkte dhe pajise medicinale, duke vepruar pa licencë veprimtarie e ka furnizuar me produkte medicinale subjektin “Isa Zeqiri” në kundërshtim me dispozitat ligjore. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin e kundërshtuar.

#### Provat e administruara

6. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim i Ministrisë së Shëndetësisë – Inspektorati Farmaceutik i Shëndetësisë me numër protokollit 05-6116 me datë 29.09.2020, Vendim i Ministrisë së Shëndetësisë – Inspektorati Shëndetësor me numër të protokollit 05-6116/3 me datë 13.11.2020, Dëshmia e pranimit në postë (prova numër 1), Dëftesa e pranimit të dërgesës me numër të pranimit 9141379, Data e pranimit të vendimit të Inspektoratit Shëndetësor (vula e postës), Ankesë ndaj Vendimit të Inspektoratit Farmaceutik me datë 16.10.2020, Faturë me nr. 0000542, Raport inspektimi në qarkulluesin farmaceutik me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale nga paditësi “Gentipharm” me dt. 28.09.2020 me numër të referencës 10/AB-049-20, Procesverbal mbi inspektimin e kryer me dt. 10.08.2020 me numër rendor 000104, Faturë me numër 1-12121.

#### Vlerësimi i gjykatës

7. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
8. Me vendimin e kundërshtuar Nr.10/K-90-20- të datës 12.11.2020 me numër protokollit 05-6116/, hedhet poshtë ankesa e parashtruar nga paditësi “Gentipharm” SH.P.K, me NUI: 810812124, me seli në Drenas, Gllogoc, me nr. protokollit 05-6116/2 e datës

20.10.2020 nga pronari D.Sh., kundër vendimit të paditurës Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Farmaceutik, me nr. protokollit 05-6116/2 të datës 29.09.2020 më të cilin i është shqiptuar gjobë paditësit në shumë prej 1000 €, për shkak të shkeljes së dispozitat ligjore të Ligjit për produkte dhe pajise medicinale, duke vepruar pa licencë veprimtarie e ka furnizuar me produkte medicinale subjektin “Isa Zeqiri” në kundërshtim me dispozitat ligjore, për shkak se është e pas afatshme.

9. Nga provat e administruara gjykata vlerësoj se vendimi me nr. protokollit 05-6116/2 të datës 29.09.2020 i nxjerrë nga Inspektorati Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë, është pranuar nga paditësi me datë 07.10.2020. Sipas këshillës juridike i njëjti është udhëzuar për të drejtën e ankesës, ta ushtroj brenda afatit prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit. Paditësi ankesën në postë e ka dorëzuar me datë 16.10.2020, pas kalimit të afatit 8 ditorë.
10. Sipas Neni 126, të LPK, Afati llogariten me ditë, muaj dhe vite. *Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.* Prandaj si ditë e fillimit të afatit llogaritet dita pas pranimit të vendimit nga paditësi, pra vendimi është pranuar me datë 07.10.2020, afati fillon të rrjedhë nga data 08.10.2020, dhe përfundon me datë 15.10.2020. Gjkata vlerëson se ankesa është dorëzuar në postë me datë 16.10.2020, pas kalimit të afatit ligjor.
11. Andaj, Gjkata vlerëson se e paditura në vendimin e kundërshtuar Nr.10/K-90-20- të datës 12.11.2020 me numër protokollit 05-6116/, drejt dhe në përputhje me dispozitat ligjore kur e ka hedh ankesën si të pas afatshme. Gjkata i vlerësoj edhe provat e tjera por konstatoj se të njëjta nuk janë me ndikim në marrjen e vendimit sepse nuk vërtetojnë një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga e paditura.
12. Andaj, bazuar në nenin 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.103/22, datë 11.04.2024.

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.